



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	10.08.2026
REFERENCË:	01-110/05-0041800-2/2026
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Z. Enes Kacapor – Koordinator i Komitetit Komunal Veprues
TEMA/SUBEKAT/SUBJECT:	Raport nga diskutimi me publikun lidhur me Planin lokal të Veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2026

Me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, datë 24.09.2020; Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; si dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur, më datë 28.07.2026, në sallën e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, është mbajtur diskutimi publik për Planin Lokal të Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Mitrovicës së Jugut për vitin 2026.

Ecuria e procesit

Njoftimi për konsultim publik është publikuar brenda afatit të përcaktuar ligjor, me qëllim të sigurimit të informimit të plotë dhe të duhur të qytetarëve dhe palëve të interesuara.

Përmes njoftimit, qytetarët dhe palët e tjera të interesuara janë informuar për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së diskutimit publik.

Njoftimit i është bashkëngjitur dokumenti i Planit Lokal të Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Mitrovicës së Jugut për vitin 2026, i cili ka qenë objekt i konsultimit publik, si dhe informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve, sugjerimeve dhe propozimeve.

Metodat e konsultimit

Metoda e konsultimit
Konsultime me shkrim / në mënyrë elektronike

Kohëzgjatja

15 ditë

Numri i pjesëmarrësve/kontribuuesve

0

Pjesëmarrja në takim

Në takim morën pjesë gjithsej 25 pjesëmarrës, prej tyre 3 gra dhe 22 burra.

Pjesëmarrja në takim

Në diskutimin publik morën pjesë gjithsej 25 pjesëmarrës, prej të cilëve 3 gra dhe 22 burra.
Në takim morën pjesë Koordinatori Komunal i Veprimit, z. Enes Kacapor, si dhe anëtarë të Komitetit Komunal të Veprimit (KKV).

Diskutimi publik për Planin Lokal të Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Mitrovicës së Jugut për vitin 2026 u mbajt më 28.07.2026, në sallën e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Qëllimi i diskutimit publik ishte prezantimi i aktiviteteve të parapara në Planin Lokal të Veprimit, në përputhje me Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali për periudhën 2022–2026, si dhe me planin përkatës të veprimit në nivel qendror.

Diskutimet, pyetjet dhe përgjigjet

Gjatë diskutimit publik, pjesëmarrësit e përkrahën hartimin e Planit Lokal të Veprimit dhe kërkuar që të sigurohet ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të tij.

Përgjigjja

Z. Enes Kacapor sqaroi se detyrë dhe obligim i Komitetit Komunal të Veprimit është hartimi i Planit Lokal të Veprimit, si dhe përcjellja dhe mbështetja e zbatimit të tij, në përputhje me Vendimin për formimin e Komitetit Komunal të Veprimit dhe me Udhëzimin Administrativ përkatës të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Nuk ka pasur pyetje, komente apo propozime të tjera nga pjesëmarrësit gjatë diskutimit publik.

Përfundim

Diskutimi publik për Planin Lokal të Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Mitrovicës së Jugut për vitin 2026 është zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore dhe administrative në fuqi.

Gjatë periudhës së konsultimit publik nuk janë pranuar komente, propozime apo sugjerime me shkrim ose në mënyrë elektronike.

Pjesëmarrësit në diskutimin publik e kanë përkrahur hartimin e Planit Lokal të Veprimit dhe kanë theksuar rëndësinë e ndjekjes së zbatimit të aktiviteteve të parapara në këtë plan.

Shtojcë

Lista e pjesëmarrësve në konsultimin publik.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Nr. 01-110/05-0041800-2/26 dt. 28.07.2026
Mitrovicë

Lista e pjesëmarrjes për konsultim publik të Planit Lokal të Veprimit
për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Mitrovicës së
Jugut 2026

Nr.	Emri e Mbiemri	Datë	Nënshkrimi
1.	IBRAHIM QOSA	28.07.2026	
2.	FEKRET LAPJAN	28.07.2026	
3.	ZEKRIA LATEI	28.07.2026	
4.	HASHKIM MUTISHI	28.07.2026	
5.	DESHIH RUSHITI	28.07.2026	
6.	SHABAN GASHIJANI	28.07.2026	
7.	Nicoll Bajrami	28.07.2026	
8.	ALDINA MUSA	28.07.2026	
9.	Vllaznim Sylaj	28.07.2026	
10.	Denise AUDIU	28.07.2026	
11.	HABIA HADINI	28.07.2026	
12.	HAUIT SECIMI	28.07.2026	
13.	BATIJAR DIBRANI	28.07.2026	
14.	NASER BATIRAMI	28.07.2026	
15.	Edin Lahi	28.07.2026	
16.	KFOR - LUT - CHE	28.07.2026	
17.	KFOR - LUT - CHE	28.07.2026	
18.	KFOR - LUT - CHE	28.07.2026	
19.	OSCE - Benjamin Hristov	28.07.2026	
20.	Bakim Koraxhiq OSBIE	28.07.2026	
21.	ARHOND JAYDA	28.07.2026	
22.	Sahin Selimi	28.07.2026	
23.	XENIT TAHIA	28.07.2026	
24.	NASER TAHIRAJ	28.07.2026	
25.	Syblon Myrvedner	28.07.2026	
26.		28.07.2026	
27.		28.07.2026	
28.		28.07.2026	
29.		28.07.2026	
30.		28.07.2026	
31.		28.07.2026	
32.		28.07.2026	
33.		28.07.2026	
34.		28.07.2026	

Mitrovicë

Kryesuesi i Komisionit

Enes Kacapor